

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gërvalla: Nga dita e parë po përgatitemi për betejën në Apel
ADRESA	https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/gervalla-nga-dita-e-pare-po-pergatitemi-per-betejen-ne-apel
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 00:33:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 17:02:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ef60dfcef5c2335061dc147da7d761287ea74de9053383a9665ba237e9488ecf
TEKSTI	4154e8dd49082e47bbfbfd725e1bd81613d9b7eaf5d8a67b866f47c2c56ad4895
PAMJA	65c7413ddf81afd85db1829a2386a4ab53dc150bc012b3086ffdba1d4130dc1f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0b5ae361f9397725329ca9bb92ab41407ac87e1615581e514eafbd939462ef2f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b10c494828e869d78c4964825696e8a5573bfada17b69bc959e4e0f8872354e0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0b5ae361f9397725329ca9bb92ab41407ac87e1615581e514eafbd939462ef2f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMET E MBRËMJES

Gërvalla: Nga dita e parë po përgatitemi për betejën në Apel



26 shtator 2026 19:02

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

Ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka mohuar akuzat për dërgim dosjesh në Gjykatën Speciale e për mungesë reagimi, pas verdiktit dënues ndaj udhëheqësve të UÇK-së. Ajo ka thënë se nga dita e parë e aktgjykimit, ka nisur punët për betejën në Apel. Gërvalla ka paralajmëruar se shpejt do të nxirret opinioni juridik edhe për projektligjin e sponsorizuar nga PDK-ja

Ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, i ka dhënë fund heshtjes në publik pas vendimit të Gjykatës Speciale, me të cilin u dënuan për krime lufte katër udhëheqës të UÇK-së: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi.

Ajo ka thënë se, meqë është ministre e Drejtësisë nuk ka folur në publik, por ka theksuar se ka vepruar me qëllimin për t'u përgatitur në betejën në shkallë të dytë.

“Kryeministri ka dhënë një deklaratë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa unë së bashku me ekipin tim, që nga dita e parë, jam futur punës me qëllim që të përgatitemi për një betejë, sepse çështja e Gjykatës Speciale është betejë ligjore, nuk është betejë deklaratash në media. Dhe si betejë ligjore, ne duhet të jemi profesionistë, të mençur, me kokën të ftohtë, pa shumë bërtima, duhet të përgatitemi për instancën e ardhshme”, ka thënë ajo në një konferencë për shtyp të shtunën.

Gërvalla ka thënë se Ministria e Drejtësisë është duke analizuar edhe projektligjin e propozuar nga Partia Demokratike për çështjet që lidhen me Dhomat e Specializuara.

“Shumica e gjërave që lidhen me dhomat e specializuara janë çështje të ekspertizës së lartë. Nevojitet kujdes i madh që të mos bëjmë gabime. Në Ministrinë e Drejtësisë janë ekspertët që po e analizojnë edhe projektligjin e propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës. Kur ta kemi gati, do t'ia dërgojmë qeverisë opinionin tonë. Nuk do ta vonojmë, shpejt do ta dërgojmë. Por as nuk duam të nxitohemi e ta naqumë me cilësi të munguar e gabime të

Futboll.

Maran e Muçi të kënaqur me fitoren e Shqipërisë

Showbiz.

“Silencio” paralajmëron albumin e ri të grupit “U2” pas nëntë vjetësh

Futboll.

Kampionia e botës e mposht Anglinë

Futboll.

Fitore bindëse e Zvicrës ndaj Maqedonisë së Veriut

Futboll.

Kroacia e nis mbarë, fiton në Çeki

Rajon.

Oligarku ukrainas në arrati merr shtetësinë e Serbisë

...papranueshme", ka thënë Gërvalla.

Tek ka folur për financimin e ekipeve mbrojtëse dhe mbështetjen financiare që Kosova ka ofruar në kuadër të mekanizmit të përcaktuar me ligj, Gërvalla ka thënë se kjo parashihet me ndryshimet kushtetuese dhe miratimit të ligjit të asaj kohe dhe jo me vendim të ministrit. Sipas saj, deri në shtator 2026, nga buxheti i Kosovës janë paguar mbi 40 milionë euro për mbrojtjen dhe obligimet e tjera që lidhen me këtë mekanizëm. Sipas saj, aktualisht Ministria e Drejtësisë nuk ka detyrime të papaguara ndaj avokatëve apo përfituesve të tjerë në kuadër të këtij programi.

Të shtunën Gërvalla u është përgjigjur edhe akuzave se ka dërguar materiale në Speciale. Ajo e ka mohuar këtë dhe ka thënë se nuk ka pasur asnjë bashkëpunim qoftë me UNMIK-un, EULEX-in apo Gjykatën Speciale.

Edhe



Arbëri • 9 o. më parë
Gërvalla mohon bashkëpunimin me Specialen: S'kam heshtur, po angazhohemi për Apelin

"Nuk kam asnjë pikë takimi, as direkt e as indirekt. Mirëpo, edhe pak durim duhet të kemi sepse aktgjykimi do të vijë shpejt dhe do ta shohim shumë shpejt. Edhe një shpresë të vogël e kam që në fakt ata që më së shumti kanë bërë titull në këtë lëmi, ata që më së shumti më kanë etiketuar me lloj-lloj emrash, të paktën para pasqyrës të skuqen për një moment që nuk kanë dashur t'i dëgjojnë faktet, por kanë zgjedhur që të përsërisin rrenat e qitura në qarkullim nga ata vetë", ka thënë Gërvalla.

Gërvalla ishte në qendër të kritikave pas vendimit të Speciales. Ajo u akuzua fillimisht se kishte dërguar dosje në gjykatë, ndërsa më pas u kritikua edhe për mungesë reagimi ndaj aktgjykimit. Në protestat e mbajtura pas vendimit të Speciales, protestuesit kërkuar edhe dorëheqjen ose shkarkimin e saj.

Egzona Mema

#DONIKA GËRVALLA

#GJYKATA SPECIALE

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 24 sht 2026
Kurti, Gërvalla dhe Sveçla nuk flasin për ndryshimin e Ligjit për Specialen



Arbëri • 22 sht 2026
Kusari-Lila kërkon konsensus e deputetë të LVV-së e PDK-së përplasen në distancë



Arbëri • 18 sht 2026
Jashari: PDK-ja duhet ta ketë Ministrinë e Drejtësisë



Arbëri • 18 sht 2026
Peci: Stop sulmeve ndaj Donika Gërvallës

apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe Interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëstëve që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Kushtet e përdorimit
Udhëzim për përdorimin e IA-së
Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.